



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 84, datë 05.06.2019

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E APELIT PËR KRIME TË RËNDA

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}; të akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 109/b/1 e 28/4, 238 e 28/4, 152/1, 278/2, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; i kallëzuar: {...}; i dëmtuar: {...}; me objekt: “Pushimi i procedimit penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë; kallëzues (viktima): {...}; me objekt: “Pushim i procedimit penal nr.378,

datë 20.02.2018 të regjistruar për veprën penale të “Mashtimit”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; me objekt: “Pushim çështje penale”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen penale me ankues: Shoqëria Përmbartimore “{...}”; kundër: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin; me objekt: “Kundërshtim vendimi sekuestrimi të datës 30.04.2019 të prokurorit{...}, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen penale me ankues: Raiffeisen Bank sh.a; kundër: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin; me objekt: “Kundërshtim vendimi nr.3069 prot., datë 03.05.2019 të prokurorit {...}për sekuestrimin e dosjes përmbartimore nr.101, datë 25.03.2019, regjistruar në referim të urdhërit të ekzekutimit nr.1246 akti, datë 24.02.2017 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me titullin ekzekutiv Kontratë Kredie me Kufi nr.4213 rep. nr.1832 kol, datë 30.10.2014”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet Kryetarit të Gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**